



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 prill 2020
Nr. ref.: RK1547/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr.KI115/19

Parashtruese

Sadete Jusufi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.53/2019, i 20 marsit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sadete Jusufi nga Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin [Rev.nr.53/2019] e 20 marsit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [Ac.nr.2945/2017] e 26 nëntorit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [C.Nr.1312/2014] e 19 majit 2017 të Gjykatës Themelore të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtrueses të kërkesës të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] e 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 8 korrik 2019, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
7. Më 18 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Gjykata gjithashtu i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 29 korrik 2019, Gjykata e njoftoi Komunën e Prishtinës dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: QKMF) për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 11 mars 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 21 shtator 1988, përmes Aktvendimit [nr.862], parashtruesja e kërkesës kishte krijuar marrëdhënie pune në cilësinë e mjekes stomatologe për kohë të pacaktuar me Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë, tashmë QKMF.
11. Më 1 janar 2000, Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: DSHMS) i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë miratoi Udhëzimin Administrativ 17/2000 për Formimin e Bordit Qendror për aftësimin e specialistëve shëndetësor (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Administrativ).
12. Udhëzimi i lartcekur Administrativ në paragrafët 5 dhe 6 të pikës D [Organizimet e Përgjithshme Organizative] të tij, ndër të tjera, përcaktoi se: (i) para fillimit të aftësimit specialistik duhet të nënshkruhet një marrëveshje nga të gjithë specializantët duke përcaktuar se pas mbarimit të suksesshëm të specializimit dhe regjistrimit, janë të obliguar të punojnë 5 (pesë) vite, me orar të plotë, në shërbimet shëndetësore publike në Kosovë, apo të paguajnë të ardhurat e plota të marra gjatë trajnimit; dhe (ii) mjekët që me sukses kanë mbaruar trajnimin e tyre specialistik dhe janë të regjistruar si specialist me leje të punës, duhet të konkurrojnë për vendet e punës në shërbimet publike shëndetësore në Kosovë. Ata nuk mund të mbeten në postet e tyre të trajnimit e as nuk mund t'ju ofrohen automatikisht poste në institucionet e trajnimit.
13. Më 17 janar 2001, përmes Vendimit [nr.910/2000] të DSHMS-së, parashtrueses së kërkesës iu lejua specializimi në lëminë e pedodoncisë dhe stomatologjisë preventive.
14. Më 3 prill 2001, parashtruesja e kërkesës dhe DSHMS nënshkruan "*Kontratën e Punës për Specializantët*". Kjo Kontratë përcaktoi, ndër të tjera, se (i) parashtrueses së kërkesës i ishte ofruar një vend pune nga 3 janari 2001 deri më 3 janar 2005, periudhë kjo brenda së cilës ajo do të paguhej treqind e gjashtëdhjetë (360) marka gjermane në muaj; dhe në shkëmbim, bazuar në pikën 10 të kësaj kontrate, (ii) pas kompletimit të suksesshëm të trajnimit profesional dhe regjistrimit si mjek i licencuar, parashtruesja e kërkesës detyrohet të punoj me orar të plotë për 5 (pesë) vite pa ndërprerje për Shërbimin Publik Shëndetësor të Kosovës apo e njëjta detyrohet të i kthej të gjitha pagat e fituara në cilësinë e specializantes.
15. Bazuar në shkresat e lëndës, pas përfundimit të specializimit, parashtruesja e kërkesës iu drejtua institucioneve relevante duke kërkuar të kthehet në vendin e saj të punës, pa sukses. Për pasojë, më 3 maj 2005, së bashku me një numër mjekësh të tjerë që kishin përfunduar specializimin e tyre, parashtruesja e kërkesës iu drejtua përmes një shkrese Institucionit të Avokatit të Popullit, duke kërkuar që të të realizohen të drejtat e tyre për kthimin në vendin e mëparshëm të punës si stomatologe dhe të kompensohen pagat e humbura.
16. Më 12 maj 2006, bazuar në shkresat e lëndës, Ministri i Shëndetësisë nxori Vendimin [nr. 20-03-2006], përmes të cilit suspendoi zbatimin e pikave 9 dhe 10 të kontratave të punës për specializantët, bazuar mbi të cilat, ishte përcaktuar detyrimi i specializantëve për të punuar për 5 (pesë) vite, në

shërbimet shëndetësore publike apo për t'i paguar të ardhurat e plota të marra gjatë trajnimit, në të kundërtën. Vendimi në fjalë ishte nxjerrë me arsyetimin se *“shkurtimet buxhetore vështirësojnë zbatimin e pikave 9 dhe 10”*.

17. Më 29 prill 2014, parashtruesja e kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore kundër QKMF-së dhe Drejtorisë së Shëndetësisë të Komunës së Prishtinës.
18. Më 19 maj 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.Nr.1312/2014] e hodhi poshtë padinë e parashtrueses së kërkesës si të paafatshme. Gjykata Themelore në Aktvendimin e saj, ndër të tjera, theksoi se (i) bazuar në Rregulloren nr.1999/24 të 12 dhjetorit 1999 për Ligjin në fuqi në Kosovë, në kontestin e punës së parashtrues së kërkesës është i aplikueshëm Ligji i Punës së Bashkuar i vitit 1976 dhe i ndryshuar e plotësuar në vitin 1987 (në tekstin e mëtejshëm: LPB); (ii) bazuar në paragrafin 1 të nenit 224 të LPB-së, kundër vendimit ose në mungesë të tij, pas afatit 30 (tridhjetë) ditore nga paraqitja e kërkesës, padia në gjykatën përkatëse mund të ngritët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh; dhe (iii) në rrethanat e rastit e duke marrë parasysh që parashtruesja e kërkesës specializimin e kishte filluar në vitin 2001 dhe e kishte përfunduar në vitin 2005, ndërsa padinë në gjykatë e kishte ushtruar me 29 prill 2014, padia e asaj para Gjykatës Themelore është e paafatshme.
19. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktvendimin të Gjykatës Themelore, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të dispozitave materiale, me propozimin që të miratohet ankesa, të priset Aktvendimi i kontestuar dhe çështja e saj të kthehet në rivendosje.
20. Më 26 nëntor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.2945/2017] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtrueses së kërkesës, duke vërtetuar Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.
21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të prishen 2 (dy) Aktvendimet e gjykatave më të ulëta dhe çështja të kthehet në rivendosje.
22. Më 20 mars 2019, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.52/2019] refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesja e kërkesës duke vërtetuar Aktvendimin [Ac.nr.2945/2017] e 26 nëntorit 2018 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [C.nr.1312/2014] e 19 majit 2017 të Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

23. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev.nr.52/2019] e 20 marsit 2019 të Gjykatës Supreme me pretendimin se është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] e nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të

KEDNJ-së, si dhe me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

24. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës në esencë thekson se (i) është aplikuar gabimisht ligji i aplikueshëm, përkatësisht LPB, përkitazi me nenin 224 të tij në lidhje me afatet brenda të cilave mund të kontestohet një vendim, sepse, sipas pretendimit, ajo asnjëherë nuk e ka pranuar një vendim të tillë. Sipas parashtrueses së kërkesës, afatet *“fillojnë të llogariten nga dita e pranimin të vendimit kontestues”*, dhe marrë parasysh që ajo asnjëherë nuk e ka pranuar vendimin përkatës, afatet përkitazi me inicimin e një kontesti, nuk kanë filluar të rrjedhin; dhe (ii) përpos faktit që vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së saj nuk i është dorëzuar asnjëherë, i njëjti është në kundërshtim me nenin 35 (Përfundimi i punësimit) të Udhëzimit Administrativ nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës. Në mbështetje të argumenteve të saj, parashtruesja e kërkesës i referohet edhe praktikës së Gjykatës, përkatësisht Aktgjykimit KI69/16, me parashtruese *Nora Dukagjini-Salihu*, Aktgjykim i 6 qershorit 2018 (në tekstin e mëtejme: rasti i Gjykatës KI69/16), siç thekson ajo *“përkitazi me dështimin e Gjykatës Supreme për të dhënë arsyetimin e duhur në aktgjykimin e dhënë lidhur me këto raste”*.
25. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës në esencë pretendon shkelje të parimit të barazisë së armëve, sepse sipas saj, *“Gjykata Supreme mori për bazë normën e cila kënaq vetëm kërkesat e njëjës palë dhe nuk mori për bazë normën e cila është detyrim për punëdhënësin dhe e drejtë e saj”*.
26. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të neneve 32 e 49 të Kushtetutës, respektivisht. Përkitazi me të parën, ajo pretendon se *“i është mohuar ajo që i garantohet nga Kushtetuta e që është e drejta e mjetit efikas juridik, të cilën e njeh edhe Konventa Evropiane dhe me këtë i është mohuar e drejta kushtetuese e paraparë me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës”*, ndërsa përkitazi me të dytën, ajo pretendon se *“përkundër kërkesave të shumta për kthimin në punë, asaj i është mohuar e drejta kushtetuese për punë dhe ushtrimin e lirshëm të profesionit të garantuar me nenin 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit), si një nga të drejtat më të rëndësishme ekonomiko sociale të njeriut”*.
27. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa e saj të (i) shpallet e pranueshme; dhe (ii) shpallet i pavlefshëm Aktvendimin [Rev.nr.53/2019] i 20 marsit 2019 i Gjykatës Supreme, duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

[...]

Kapitulli II Të Drejtat dhe Liritë Themelore

[...]

Neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm)

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Titulli I Të Drejtat dhe Liritë

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

Ligji i Punës së Bashkuar (LPB) i vitit 1976 i ndryshuar dhe plotësuar në vitin 1987

Neni 224

1. *Nëse punëtori nuk është i kënaqur me vendimin e organit apo nëse organi kompetent nuk merr vendim, në afat prej 30 ditësh prej ditës kur është ushtruar kërkesa, punëtori ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e të drejtave pranë gjykatës.*

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

31. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 53/2019] e 20 marsit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të

përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ajo pretendon se i janë shkëlur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

32. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i Rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

33. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës që nga viti 1988 kishte një kontratë për marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me paraardhësen e QKMF-së. Në vitin 2001, asaj iu lejua specializimi për një periudhë 3 (tre) vjeçare të mbështetur nga një pagesë, në shkëmbim për të cilën parashtruesja e kërkesës ishte e detyruar të punoj 5 (pesë) vite për shërbimin publik shëndetësor. Kjo marrëveshje ishte e bazuar në Udhëzimin Administrativ, dhe i cili, siç është cekur më lart, në paragrafin 5 të tij kishte përcaktuar detyrimin e specializantëve për të punuar për periudhën e lartcekur në shërbimet shëndetësore publike, ndërsa në paragrafin 6 të tij, kishte theksuar se të njëjtit duhet të konkurronin në vendet e punës në sektorin publik dhe se jo detyrimisht i kanë të garantuara postet në institucionet e trajnimit të specializimit.
34. Bazuar në shkresat e lëndës, pas përfundimit të specializimit, parashtruesja e kërkesës iu drejtua institucioneve relevante duke kërkuar të kthehet në vendin e saj të punës, përfshirë edhe Institucionit të Avokatit të Popullit. Ndërsa, gjykatave iu kishte drejtuar në vitin 2014, kur kishte ngritur padinë në Gjykatën Themelore, proces gjyqësorë ky i cili kishte përfunduar në vitin 2019, pasi të tri instancat e gjykatave të rregullta, kishin refuzuar padinë, ankesën dhe revizionin e parashtrueses së kërkesës, respektivisht, duke arsyetuar se padia fillestare e saj e vitit 2014, ishte e paafatshme. Parashtruesja e kërkesës konteston këtë konstatim të gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke ngritur pretendime që ndërlidhen në esencë me garancitë procedurale të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me neni 6 të KEDNJ-së, duke vënë theks në (i) interpretimin e gabuar të LPB-së bazuar në të cilin gjykatat e rregullta kishin shpallur padinë e saj si të paafatshme; dhe (ii) faktin se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së saj, përpos që nuk iu kishte dorëzuar, ishte edhe në kundërshtim me rregullativën e aplikueshme ligjore.
35. Në këtë kontekst dhe në vijim, Gjykata do të i trajtoj pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me (i) shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, e që në rrethanat e rastit konkret në esencë ndërlidhen me interpretimin e gabuar të ligjit; dhe (ii) shkeljen e neneve 24, 32 dhe 49 të Kushtetutës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) *Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së*

36. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se praktika e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtrueses të kërkesës, Gjykata do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
37. Më tej dhe sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës që ndërlidhen me interpretimin e gabuar të ligjit, përkatësisht nenit 224 të LPB-së, Gjykata fillimisht thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund të i shqyrtojë ato. (Shih rastin e Gjykatës nr. KIO6/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; rastin KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; dhe KI49/19 parashtrues *Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim për Papranueshmëri i 10 tetorit 2019, paragrafi 47).
38. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 37; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 57; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48).
39. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-

së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 49).

40. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjedhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
41. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerret masa kur argumentohet se një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës. (Përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
42. Në këtë kontest, Gjykata vëren që në rrethanat e rastit konkret, çështja esenciale ndërlidhet me afatshmërinë e padisë së parashtrueses së kërkesës dhe me pretendimin e saj se ajo asnjëherë nuk ka pranuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Siç u cek më lart, parashtruesja e kërkesës pretendon se këtë vendim nuk e ka pranuar asnjëherë dhe se rrjedhimisht, afatet për ankesë kundër të njëjtin nuk kanë filluar, duke e pamundësuar kështu shpalljen e padisë së saj të paafatshme. Në anën tjetër, gjykatat e rregullta pasi kanë përcaktuar se në rrethanat e rastit të parashtrueses së kërkesës është i aplikueshëm LPB, duke u bazuar në nenin 224 të tij, kanë përcaktuar se padia e saj është e paafatshme pa marrë parasysh nëse parashtruesja e kërkesës ka pranuar vendimin përkatës apo jo. Kjo sepse sipas arsytimit të gjykatave të rregullta, neni 224 i LPB-së, përfshinë të dy mundësitë, afatin e ankesës kundër një vendimi, dhe afatin e ankesës nëse nuk është nxjerrë apo dorëzuar një i tillë. Në rastin e parë, afati i ankesës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga nxjerrja e vendimit, ndërsa në rastin e dytë, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, pas 30 (tridhjetë) ditësh prej kur është ushtruar një kërkesë dhe organi përkatës nuk ka nxjerrë vendim. Gjykatat e rregullta, më tej kanë theksuar se parashtruesja e kërkesës e kishte përfunduar specializimin më 3 janar 2005, ndërsa padinë në gjykatën përkatëse e kishte parashtruar më 29 prill 2014, pra 9 (nëntë) vite pas përfundimit të specializimit.
43. Për më tepër, Gjykata vëren se të gjitha gjykatat e rregulla kishin adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesës së kërkesës, që ndërlidhen me (i) afatshmërinë e padisë së saj dhe pretendimeve për mospranimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, fakt ky mbi bazën e të cilit parashtruesja e kërkesës pretendon se afatet ligjore për dorëzimin e padisë nuk mund të rrjedhin duke e pamundësuar kështu shpalljen e padisë së saj të

paafatshme; dhe (ii) kundërligjshmërinë e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së saj të punës.

44. Për sa i përket çështjes së parë, përkatësisht afatshmërisë së padisë, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit të saj [C. nr. 1312/2014] të 19 majit 2017, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Gjykata duke vlerësuar afatshmërinë e padisë së ushtruar, nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konstatoi se paditëses me Vendimin nr.ref.910/2000 të datës 17.01.2001 i është lejuar specializimi nga lëmia Pedodoncia dhe Stomatologjia Preventive me datë 03.01.2001, pastaj me kontratën e punës për specializant e datës 03.04.2001, rezulton se paditësja ka filluar specializimin me datë 01.03.2001 ndërsa ka përfunduar me datë 03.01.2005, kurse padinë në gjykatë e ka ushtruar me datë 29.04.2014 dhe se kjo rezulton me lëshimin e afateve ligjore për mbrojtje të drejtave pranë gjykatës, kështu që paditësja padinë e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, pas nëntë viteve, nga dita e kryerjes së specializimit.

Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata vërtetoi se paditësja ka lëshuar afatin për mbrojtjen e të drejtave të cenuara, ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 224. par.1 të Ligjit të Punës së Bashkuar i vitit 1976 i ndryshuar dhe plotësuar në vitin 1987 ku parashihet “ nëse punëtori nuk është i kënaqur me vendimin e organit apo nëse organi kompetent nuk merr vendim, në afat prej 30 ditësh prej ditës kur është kur është ushtruar kërkesa, punëtori ka të drejtë që në afatin prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e të drejtave para Gjykatës së Punës së Bashkuar”- Ligj ky i aplikueshëm në Kosovë sipas rregullores së UNMIK-ut 1999/24, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësja nuk është kthyer në punë pas specializimit”.

45. Ndërsa, duke adresuar të njëjtin pretendim, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të saj [Ac. nr. 2945/17] të 26 nëntorit 2018, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet ankimore të paditëses se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i kundërligjshëm dhe se është me aplikim të gabuar të dispozitave materiale, përkatësisht nenit 224 të LPB-së. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm se pse në rastin konkret gjenë zbatim ligji i lartëcekur... [].

Po ashtu, për Gjykatën e Apelit rezulton si i pabazuar pretendimi i paditëses i paraqitur me ankesë se paditësja nuk e ka pranuar asnjëherë vendimin për ndërprerjen e punës nga e paditura e parë dhe në këtë rast nuk mund të plotësohet kushti i paraparë me dispozitën e nenit 224 të LPB-së. Kjo për faktin se neni i lartcekur në paragrafin 1 përcakton decidivisht se nëse organi kompetent nuk merr vendim në afat prej 30 ditësh prej kur ushtrohet kërkesa, punëtori ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës drejtpërdrejtë në gjykatë”.

46. Në fund, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [Rev.nr. 53/2019] të 20 marsit 2019, gjithashtu kishte konfirmuar Aktvendimet e gjykatave paraprake, duke arsyetuar si në vijim:

“Pretendimet tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga neni 224 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar po ashtu u refuzuan si të pabazuara, kjo ngase ajo dispozitë ligjore dhe Ligji mbi Punën e Bashkuar në përgjithësi ka qenë i datës para 23 mars 1989 dhe si i tillë ka qenë në aplikim sipas rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24, mirëpo, për shkak se në atë kohë, e deri në nxjerrjen e Ligjit të Punës 03/L-212, ka qenë në fuqi Ligji special nga marrëdhënia e punës, Gazeta Zyrtare nr.42/90, në të cilin ka ekzistuar dispozita ligjore e nenit 83, me përmbajtje plotësisht të njëjtë sikur edhe neni 224 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar ku janë paraparë afatet ligjore për mbrojtje gjyqësore 30 + 15 ditë. Këto afate paditësja nuk i ka respektuar, por pas 9 viteve prej kohës që ka kryer specializimin, gjykatës i është drejtuar me padi për kthim në punë. Pretendimet tjera të revizionit gjykata i vlerësoi irelevante pasi që ishin me pa ndikim me vendosjen ndryshe lidhur me revizionin e paraqitur nga i autorizuari i paditëses”.

47. Rrjedhimisht dhe siç është elaboruar më lart, Gjykata vëren që të gjitha gjykatat e rregullta kishin konstatuar se parashtruesja e kërkesës kishte ushtruar padinë e saj jashtë afatit ligjor të përcaktuar bazuar në ligjin e aplikueshëm dhe kishin trajtuar të gjitha pretendimet e saj të paraqitura para tyre e që ndërlidhen me interpretimin e nenin 224 të LPB-së.
48. Gjykata, siç është cekur më lart, gjithashtu vë theks në faktin se gjykatat e rregullta kanë adresuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me mospranimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke u bazuar në po të njëjtën dispozitë. Sipas gjykatave të rregullta, rrethanat e tilla janë të parashikuara përmes paragrafit 1 të nenit 224 të LPB-së e sipas të cilit në rast të mosveprimit të organit të administratës brenda 30 (tridhjetë) ditësh, ankesa bëhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pranë gjykatës përkatëse.
49. Ndërsa, për sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht kundërligjshmërisë së vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së saj të punës, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit të saj kishte theksuar se të njëjtat ndërlidhen me themelësinë e kërkesëpadisë dhe se duke marrë parasysh që kjo e fundit është shpallur si e paafatshme, Gjykata Supreme nuk mund të i shqyrtoj ato. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme, kishte theksuar si në vijim:

“Për këto pretendime të revizionit, Gjykata Supreme nuk mund të japë vlerësim, pasi që padia e paditëses është hedhur si e pas afatshme, kështu që nuk ka mundësi të lëshohet në themelësinë e kërkesëpadisë përderisa ajo trajtohet si e pas afatshme. Nëse pretendimet e revizionit kanë të bëjnë me shkelje procedurale që lidhen me të hedhurit si të pas afatshme të padisë së paditëses, ato ka mundësi që të shqyrtohen e të vlerësohen, kurse pretendimet e tilla të paraqitura në revizion rreth asaj se pse paditëses sot e kësaj dite nuk i është lëshuar vendim me të cilin i është ndërprerë marrëdhënia e punës, as para as pas kryerjes së specializimit, nuk mund

të shqyrtohen me që ato kanë të bëjnë me themelësinë e kërkesëpadisë, e themelësia e kërkesëpadisë në rastin konkret nuk është objekt shqyrtimi e vlerësimi”.

50. Gjykata gjithashtu rikujton që, parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën, duke u referuar gjithashtu në rastin e Gjykatës KI69/16.
51. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se përveç faktit që parashtruesja e kërkesës ka cekur dhe ka cituar rastin e Gjykatës KI69/16, ajo nuk ka elaboruar lidhshmërinë e tij, faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret. Gjykata thekson që arsyetimet e vendimeve tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë. (Shih ndër të tjera dhe në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)*, paragrafi 275; rastin KI 119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për Papranueshmërisë, i 3 majit 2019, paragrafi 80; dhe rastin KI49/19, cituar më lart, paragrafi 44).
52. Megjithatë, Gjykata vëren që rrethanat faktike të parashtrueses së kërkesës në rastin konkret janë të ngjashme më ato të rastit të cilit ajo i referohet. Më specifikisht, të dy rastet ndërlidhen me (i) lidhjen e kontratave si stomatologe të parashtrueseve përkatëse me kohë të papërcaktuar në fund të viteve të 80-ta dhe fillim të viteve të 90-ta, me tashmë QKMF-në; (ii) nxjerrjen e vendimeve dhe lidhjen e kontratave për specializim në vitin 2001, duke u bazuar në Udhëzimin përkatës Administrativ; dhe (iii) refuzimin e institucioneve përkatëse shëndetësore për kthimin e parashtrueseve në vendet përkatëse të punës pas përfundimit të specializimeve në vitin 2005.
53. Por për dallim, në rastin të cilit parashtruesja e kërkesës i referohet, parashtruesja përkatëse (i) menjëherë pas refuzimit të kthimit të saj në punë, iu kishte drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme KPMK), dhe i cili e refuzoi ankesën e parashtrueses; më pas e njëjta (ii) menjëherë ankimoi këtë vendim në Gjykatën Themelore dhe e cila miratoi kërkesëpadinë e saj, vendim ky i cili më pas u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit; (iii) në vitin 2015, kishte filluar procedurën përmbarimore dhe Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kishin miratuar propozimet për përmbarim dhe kishin refuzuar ankesat përkatëse, respektivisht; ndërsa (iv) duke vepruar sipas kërkesës për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës se Apelit, Gjykata Supreme kishte pranuar revizionin e të paditurës, duke i anuluar vendimet e gjykatave më të ulëta. Këtë vendim të Gjykatës Supreme, Gjykata përmes rastit KI69/16 e shpalli në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për arsyet të cilat janë të elaboruara në Aktgjykimin përkatës. (Për faktet e rastit shih paragrafët 9 - 36, ndërsa për arsyetimin shih paragrafët 46 - 85 të Aktgjykimit në rastin KI69/16).
54. Për më tepër, në dallim thelbësorë prej rastit KI69/16 e në të cilin thirret parashtruesja e kërkesës, kjo e fundit në rrethanat e rastit konkret, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik prej vitit 2005, vit ky në të cilin ka përfunduar specializimi i saj dhe deri në vitin 2014, në të cilin ajo kishte ngritur padinë për herë të parë në Gjykatën Themelore. Për pasojë, gjykatat e rregullta kishin

shpallur të paafatshme kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës të ngritur në vitin 2014, duke e aplikuar ligjin e aplikueshëm në rrethanat e vitit 2005, përkatësisht LPB-në. Brenda kësaj periudhe në të cilën parashtruesja e kërkesës nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim, parashtruesja në rastin KI69/16, iu ishte drejtuar KMPK-së, kishte atakuar vendimin e saj, kishte fituar rastin në Gjykatën Themelore e të Apelit, dhe kishte fituar, përkatësisht marrë konfirmimet e Gjykatës Themelore e të Apelit, në procedurë përmbarimore.

55. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykata e rregullta kishin trajtuar dhe arsyetuar në tërësinë e tyre pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe se procedurat para gjykatave në rrethanat e rastit konkret, në asnjë mënyrë nuk rezultojnë të kenë qenë të padrejta apo arbitrare. Për më tepër që, argumentet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me rastin e Gjykatës KI69/16 gjithashtu, siç është sqaruar më lart, nuk qëndrojnë.
56. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës. (Shih në këtë aspekt, rastet e Gjykatës nr. KI42/16 Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).
57. Gjykata gjithashtu rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih rastet e Gjykatës KI118/17 parashtrues *Šani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).
58. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimin e ngritur nga parashtruesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesja e kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet mjaftueshëm pretendimin e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

(ii) *Sa i përket pretendimeve për shkelje të neneve 24, 32 e 49 të Kushtetutës*

59. Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se në rrethanat e rastit konkret, Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të drejtave dhe lirive të saj themelore, të garantuara përmes neneve 24, 32 e 49 të Kushtetutës.

60. Përkitazi me këto pretendime, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë që parashtruesja e kërkesës nuk është e kënaqur me rezultatin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 58).
61. Megjithatë, dhe sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim, në mënyrë që një çështje të ngritet në kuadër të nenit 24 të Kushtetutës dhe atë 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së, duhet të ekzistojë dallimi në trajtim ndërmjet personave në situata të ngjashme ose të krahasueshme. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *X dhe të tjerët kundër Austrisë*, Aktgjykim i 19 shkurtit 2013, paragrafi 98). Për më tepër që, jo çdo dallim në trajtim përbën shkelje të neneve të lartcekura. Në parim, dallimi në trajtim do të jetë diskriminues nëse i mungon justifikimi objektiv apo i arsyeshëm; thënë ndryshe, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse mungon marrëdhënia e arsyeshme ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimit që synohet të arrihet. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Guberina kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 22 marsit 2016, paragrafi 69 dhe referencat tjera të përmendura aty). Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesja e kërkesës nuk ka saktësuar asnjë pretendim përkitazi me ndonjë dallim në trajtim dhe rrjedhimisht nuk ka arsyetuar dhe as mbështetur pretendimet e saj për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës.
62. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, Gjykata rikujton që në parim dhe në tërësinë e tij, neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave] i Kushtetutës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, neni 32 i Kushtetutës për të drejtën në mjet juridik dhe neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive) i KEDNJ-së për të drejtën për zgjidhje efektive, garantojnë: (i) të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj; (ii) të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (iii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iv) të drejtën për një zgjidhje efektive në nivel vendor, nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me KEDNJ. (Shih rastin, KI48/18, cituar më lart, paragrafët 195-198).
63. Megjithatë, Gjykata rithekson se parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk mbështet pretendimet e saj për shkelje të këtyre të drejtave. Gjykata në fakt, thekson se parashtruesja e kërkesës ka pasur mjet juridik efektiv në dispozicionin e saj dhe se lëshimi i afateve për dorëzimin e kërkesëpadisë e ankesave në asnjë mënyrë nuk mund të rezultojë në pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, respektivisht.
64. Në të kundërtën, Gjykata vazhdimisht ka theksuar se është detyrë e parashtruesve të kërkesës apo përfaqësuesve të tyre që të veprojnë me *'kujdes*

të nevojshëm' për t'u siguruar se kërkesat e tyre për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore janë dorëzuar brenda afatit ligjor. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Mocanu dhe të Tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 17 shtatorit 2014, paragrafët 263-267, po ashtu shih rastin e Gjykatës, KI140/17, parashtrues *Merita Dervishi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 14 qershorit 2019, paragrafi 64).

65. Në fund, dhe sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, Gjykata thekson se në kuptimin e kësaj të drejte konkrete, Kushtetuta përkufizon një standard që përcakton garancitë dhe të drejtat për të punuar, mundësitë e punësimit dhe të sigurimit të kushteve të barabarta të punës pa diskriminim, si dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës dhe ushtrimit të profesionit në mënyrë të lirë, pa detyrime të dhunshme. Këto të drejta në mënyrë specifike janë të rregulluara me ligjet e aplikueshme. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI46/15, me parashtrues *Zejna Qosaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 tetorit 2015, paragrafi 26; dhe KI70/17, parashtrues *Rrahim Ramadani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 majit 2018, paragrafi 48).
66. Gjykata thekson se pretendimi i parashtrueses së kërkesës për shkeljen e të drejtës në punë duhet kuptuar në dritën e interpretimit të mësipërm. Gjykata gjithashtu vëren se pretendimi i parashtrueses së kërkesës, në rastin konkret, nuk ka të bëjë me mohimin e të drejtës në punë dhe ushtrim të profesionit, sipas kuptimit të nenit 49 të Kushtetutës.
67. Gjykata konsideron se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e ndalon parashtruesen e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtrueses së kërkesës që do të arsyetonte konkludimin se janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI136/14, cituar më lart, paragrafi 34; si dhe KI42/17, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 53).
68. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e saj se procedurat pranë gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes Aktvendimit të kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e lartcituara dhe të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i 30 qershorit 2009).
69. Gjykata në fund thekson se parashtruesja e kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat*

kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës Lumturije Murtezaj, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

70. Si rezultat, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 dhe 47 të Ligjit dhe të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 mars 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi